

MASAT

Shmangni levizjet

Si ne hyje dhe në lënie te territorit, ashtu si edhe brenda tyre, njerëzve u kërkohet të lëvizin vetëm për:

- nevoja pune;
- situata të domosdoshme;
- arsye shëndetësore.

Është e ndaluar që të gjithë njerëzit të lëvizin ose të transferohen, me mjete të transportit publik ose privat, në një bashki tjetër nga ajo në të cilën ndodhen aktualisht, përveç se për nevoja të provuar pune, për urgjenca absolute ose për arsye shëndetësore

Gjate diteve të fundit, si dhe dita që paraprindet e dita që vjen pas tyre, është e ndaluar çdo lëvizje drejt shtëpive të ndryshme nga vendbanimi, përfshirë shtëpitë e dyta të përdorura për pushime.

Nuk lejohet të zhvillohen aktivitete rekreative e lojëra në natyrë. Lejohet të kryejë veprimtari sportive individuale në afërsi të shtëpisë tuaj, me kusht që, të respektohet distanca prej të paktën një metër nga personat e tjerë.

Ndalohet hyrja në parqe, vila, zona për lojëra dhe kopshte publike.

Shëndeti dhe respekti për karantinën

Personave me simptoma të infeksionit të frymëmarrjes dhe me temperaturë më të lartë se 37.5 gradë, ju rekomandohet të qëndrojnë në shtëpi dhe të kufizojnë sa më shumë kontaktet sociale, duke kontaktuar mjekun e tyre të familjes. Për personat që i janë nënshtruar karantinës ose janë testuar pozitivisht për virusin, është rreptësisht e ndaluar të largohen nga shtëpia e tyre.

Pezullohen cerdhet, shkollat dhe universitetet

Janë të ndërprera shërbimet edukative për fëmijë, aktivitetet arsimore në shkollat e të gjitha niveleve, si dhe vijimi i shkollës dhe aktivitetet e arsimit të mesëm, përfshirë universitetet dhe institucionet e Formimit të Lartë Artistik, Muzikor dhe Koreotik, kurset profesionale, master, kurse për profesionet shëndetësore dhe universitetet për të moshuarit, si dhe kurset profesionale dhe aktivitetet e trainimit të kryera nga organe të tjera publike, përfshirë autoritetet lokale dhe subjektet private. Mbetet mundësia e kryerjes së aktivitetet të mësimin në distancë, me përjashtim të kurseve për mjekë në trajnime të specializuara dhe kurse specifike trainimi në mjekësi të përgjithshme, si dhe aktivitete të trajnuarve në profesionet e shëndetit.

Pezullohen aktivitetet e organizuara, kinematë, teatrot, sallat e bingos, diskot

Të gjitha aktivitetet janë pezulluar në vendet në vijim: kinematë, teatrot, pabet, shkollat e vallëzimit, sallat e lojërave, sallat e basteve dhe sallat e bingove, diskot dhe vende të ngjashme. Të gjitha aktivitetet e organizuara janë pezulluar, si dhe aktivitetet në një vend publik ose privat, përfshirë ato të një natyre kulturore, rikreative, sportive, fetare dhe të ekspozitave, edhe nëse mbahen në vende të mbyllura, por të hapura për publikun, siç janë për shembull, aktivitete të mëdha.

Mbyllen Muzete dhe bibliotekat

Janë të mbyllura muzete, bibliotekat dhe arkivat, zonat dhe parqet arkeologjike dhe komplekset monumentale

AKTIVITETE SHPERNDARJEJE

Janë pezulluar aktivitetet e shërbimeve të restoranteve (përfshirë klubet, pabet, restorantet, dyqanet e akulloreve, pasticërite). Duke marrë si shembull dhe për të plotësuar listën e mësipërme të veprimtarive të pezulluara, duhet të përfshihen edhe picërite, picërite pa vende për tu ulur, shish kebabët, rosticërite, etj.

Janë të mbyllura bizneset e shpërndarjes së ushqimit dhe pijeve, të vendosura brenda stacioneve hekurudhore dhe liqenore, si dhe në zonat e shërbimit dhe të karburantit, me përjashtim të atyre që ndodhen përgjatë autostradave, të cilat mund të shesin vetëm produkte që do të konsumohen jashtë ambienteve;

MBETEN TË LEJUARA :

- vetëm bizneset që përgatisin ushqimet me ofrimin në shtëpi në përputhje me standardet e higjienës dhe shëndetit, si për paketim ashtu edhe për transport
- veprimtaritë e mensave dhe furnizimi me ushqim të vazhdueshëm mbi baza kontraktuale, të cilat garantojnë distancën e sigurisë ndërmjet personave prej një metri.
- veprimtaritë e bizneseve që shpërndarndajne ushqime dhe pije të vendosura në spitale dhe aeroporte, me detyrimin për të siguruar në çdo rast respektimin e distancës midis personave prej të paktën një metër.

Mbyllja e strukturave të mesme dhe të mëdha të shitjeve në fund jave (përveç farmacive, para farmacive dhe dyqaneve ushqimore)

Strukturat e shitjeve të mesme dhe të mëdha dhe dyqanet brenda qendrave tregtare janë të mbyllura gjatë fund javes, me përjashtim të farmacive, parafarmacive dhe dyqaneve ushqimore. Në këto struktura, duhet të lejohet qasja e personave vetëm në hapësirat e dedikuara për shitjen e produkteve që lidhen me aktivitetet e autorizuara. Prandaj, supermarketet në qendrat tregtare mund të hapen gjatë fund javes vetëm për zonat e shitjes së produkteve farmaceutike, para farmaceutike dhe ushqimore. Në çdo rast, duhet të garantohet distanca midis personave prej nje metër, dhe gjithashtu përmes modulimit të orëve të hapjes. Eshtë e ndaluar cdo formë grumbullimi.

Pezullohen Palestra, pishina, qendra sportive

Janë të pezulluara aktivitetet e palestrave, qendrave sportive, pishinave, qendra noti, spa, llixhave (përveç sigurimit të shërbimeve që hyjne në nivelet thelbësore të ndihmës), qendrat kulturore, qendrat sociale, qendrat e kohës së lirë. Këto aktivitete, të cilave u shtohen qendrat ditore, pezullohen edhe në krahinat e tjera, në bazë të urdhrit të Presidentit Bonaccini.

Vendet fetare. Pezullohen ceremonite funerale

Hapja është e kushtëzuar nga miratimi i masave organizative siç është shmangia e grumbullimit të njerëzve, duke marrë parasysh madhësinë dhe karakteristikat e vendeve, të tilla që tju garantojnë vizitorëve mundësinë e respektimit të distancës midis tyre prej të paktën një metër.

Pezullohen ceremonite civile dhe fetare, përfshirë ceremonitë e varrimit.

Garat dhe aktivitetet sportive

Janë të pezulluara aktivitetet sportive dhe garat e të gjitha llojeve dhe disiplinave, në vende publike ose private. Lejohet zhvillimi i tyre, si dhe seancat stërvitore të sportistëve profesionistë dhe atletëve të kategorisë absolute që marrin pjesë në lojërat Olimpike, në aktivitetet kombëtare ose ndërkombëtare, në ambiente të brendshme sportive të zhvilluara me dyer të mbyllura, ose jashtë tyre pa praninë e publikut . Në çdo rast, shoqatat dhe klubet sportive, përmes stafit të tyre mjekësor, janë të detyruar të kryejnë kontrolle të përshtatshme për të përmbajtur rrezikun e përhapjes së virusit COVID19 mes atletëve, teknikëve, menaxherëve dhe të gjithë personave shoqërues që marrin pjesë.

Janë të mbyllura impiantet e skive

Aplikim për leje të zakonshme dhe leje të posaçme

Punëdhënësve publikë dhe privatë ju rekomandohet të promovojnë përdorimin nga punonjësit e periudhave të lejeve zakonshme dhe lejeve të posacme, pa cënuar dispozitat e rregullave për aplikimin e punës së thjeshtezuar (smart working).

Pezullohen Konkursset

Procedurat e konkurimit publik dhe privat pezullohen me përjashtim të rasteve në të cilat vlerësimi i kandidatëve kryhet ekskluzivisht në baza kurrikulare ose elektronike. Përjashtohen nga pezullimi konkursset për personelin shëndetësor, provimet shtetërore dhe ato të kualifikimit për praktikimin e profesionit të kirurgut dhe personelit të mbrojtjes civile, të cilat preferohet të zhvillohet në distancë ose, në të kundërt, duke garantuar distancën e sigurisë midis personave prej një metër.

Pezulluar lejet

Janë pezulluar lejet e personelit mjekësor dhe teknik, si dhe personeli, veprimtaritë e të cilëve janë të domosdoshme për të menaxhuar aktivitetet e kërkuara nga njësitë e krizave të ngritura në nivelin rajonal.

Takime me video konference

Kur zhvillohen takime, në të gjitha rastet e mundshme, duhet të adoptohen metodat e komunikimit në distancë me referencë të veçantë strukturave shëndetësore dhe socio-sanitare, shërbimet publike dhe koordinimet që aktivizohen në kontekstin e urgjencës COVID-19. Në çdo rast, duhet të garantohet respektimi i distancës së sigurisë ndërmjet personave prej një metër.

Pezullohen provimet për patenten

Pezullohen provimet për patenten që duhet të përfundojë në zyrat periferike të Motorizimit civil. Ehtë vendosur një zgjatje afati në favor të kandidatëve që nuk kanë arritur të bëjnë provimin për shkak të këtij pezullimi.